ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK

Për Aktivitetin e Prokurimit

Titulli: Shërbimet e Dezinfektimit;Dezinsektimit dhe Deratizimit

Nr1 i prokurimit	**652-24-6096-2-2-1**
Nr i brendshëm	

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Besim A.Zejnullahu B.I
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Reqakut,p.n
(Adresa)
Ferizaj ***70000***
(Vendi) *(Kodi postar)*
044138490
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Besim Zejnullahu
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
ekoddd@hotmail.com
(Adresa elektronike)

18.04.2025
(Data e parashtrimit të kërkesës)

BESIM A. ZEJNULLAHU B.I.
N.SH. "EKO-DDD"
FERIZAJ

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- *Njoftimi për kontratë dt.18.06.2024*
- *Afati i fundit për dorëzim të tenderit dhe hapje të tenderit 10.07.2024*
- *Njoftimi për vendimin për dhënje të kontratës 24.07.2024*
- *Tenderi i përgjëgjshëm me Çmim më të ulët*
- *Njoftimi për dhënie të kontratës dhe letrën standarde për tenderuesit e eliminuar me dt.24.07.2024*
- *Vendimi për kërkesën për rishqyrtim 01.08.2024 (i pranuar me 07.08.2024)*
- *Vendimi mbi Anulimin e Aktivitetit te Prokurimit 04.04.2025*
- *Vendimi mbi Refuzimin e kerkeses per rishqyrtim 10.04.2025*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Kundër Njoftimit per Anulim te Aktivitetit te Prokurimi "Shërbimet e Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit" me nr.të prokurimit 652-24-6096-2-2-1 *kemi parshtruar kërkesë për ri-shqyrtim tek AK-* **KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK** *me dt. 06.04.2025.*

AK- KUVENDI I KOMUNES – KAÇANIK *me dt. 10.04.2025 na njofton me vendimin mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit :* "Shërbimet e Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit" me nr.të prokurimit 652-24-6096-2-2-1 *me arsyetimin se kerkesa per ri-shqyrtim eshte e pa bazuar.*

Arsyetimi i tyre për refuzim i cili është shënuar në Vendim është si në vijim: ***"Duke u bazuar në Pretendimet e juaja ne si autoritet Kontraktues mendojm se kerkesat e juaja jane të pa baza nga shkaku se në bazë të ankesa te njëpasnjëshme te OE ka kaluar koha per implementimin e projektit, se dihet periudhe kur behet DDD andaj edhe ne si autoritet kontraktues kemi marrë vendimin për Anulim të procedurës së Prokurimit me Nr.652-24-6096-2-2-1, arsyeja nuk është e cekur në dosje të tenderit po as në njoftimin për kontratë se projekti kalon edhe ne vitin 2025 por është caktu Afati i liferimit që duhet te perfundoje mbrenda 10 ditë pas lidhjes se kontratë të vitit 2024. Si dhe këkesa e njesis kerkuese per anulim e dates 19.09.2024, për arsye se nuk është koha qe të kryhet projekti per Dezinfekitm, Dezinsektim dhe deratizimin e objekteve dhe Hapsirave publike. Andaj dhe nuk e kemi pare të Arsyeshme te ju kerkojmë shtyrjen e validitetit te ofertës sipas Nenit 30. Sa i perket Pretendimit per sigurimin e ofertës qëndron Por AK ka bëre gabim teknik dhe kerkon Ndjes për këtë Gabim se nuk është kërkuar Sigurimi i ofertës "***

Arsyetimet e AK – KUVENDI I KOMUNES – KAÇANIK janë të pa pranueshme nga ana e jonë pasiqë AK me këtë vendim bie në kundërshtim me një mori Nene të LPP-së.

Bazuar në dispozitat e nenit 109 të LPP parashtroj ankesë kundër vendimit për refuzim të kërkesë për ri-shqyrtim si dhe kundër njoftimit për Anulim te procedurës së prokurimit me Nr.652-24-6096-2-2-1.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- **Dispozitat e shkelura:**
- **Neni 1 i LPP**
- **Neni 7 i LPP**
- **Neni 9 i LPP**
- **Neni 59 i LPP**
- **Neni 62 i LPP**
- **Neni 108/A i LPP**

Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në pajtim me dispozitat e nenit 109 të LPP-ës parashtrojmë këtë ankesë kundër vendimit të AK KUVENDI I KOMUNES – KAÇANIK mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim si dhe kundër njoftimit për Anulim te procedurës së prokurimit me Nr.652-24-6096-2-2-1.

Në filllim po shenojmë disa detaje për ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit ku do të shihet qartë se si AK ka bërë shkelje të njepasnjëshme në secilin veprim të tyre në lidhje me këtë aktivitet.
Me datë 24.07.2024 kemi pranuar Njoftimin për dhënie të kontratës dhe letrën standarde për tenderuesin e eliminuar e cila na përkiste neve si OE. Pas qasjes në dokumetet e OE fitues Ne kemi derguar kërkse për rishqyrtim pranë AK-së me datë 28.07.2024, ndërsa nga AK kemi pranuar vendimin me datë 07.08.2024 në të cilin shkruante Aprovohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim dhe lënda kthehet në rivleresim. Që nga ajo datë AK nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me këtë AP duke i tejkaluar të gjitha afatet ligjore për rivlërsim dhe ne si OE duke e parë që rivlersimi u sterzgjatë iu kemi shkruar e-mail me datë 05.12.2024 por nuk kemi pranuar asnjë përgjigje nga ana e AK. Pastaj me datë 03.04.2025 kemi dërguar serish e-mail dhe kemi kërkuar përgjigje dhe të njejtin e-mail e dërguam edhe ne E-prokurim, dhe vetëm atëherë AK u zgjua dhe mori një vendim i cili sërish e bënë edhe një shkelje te LPP-se duke e anuluar AP me arsyetimet per te cilat te gjitha ishin shkelje ligjore nga ana e tyre.

Arsyetimi në Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit të prokurimit ishte:
Aktiviteti i prokurimit eshte inicuar 18.06.2024 prokurimit te vitit 2024, pershak se ka kaluar edhe vlefshmeria e ofertave si dhe sigurimi i ofertes si dhe kerkeses se njejise kerkuese per Anulimin e porcedures nga shkaku se ka kaluar koha nga te cilet eshte parapare te behet Dezinfekitmi, Dezinsektimi dhe Deratizimi i objekteve.

Më tutje e sqarojme se si është dërguar kërkesa jone per rishqyrtim pranë AK-së

Pretendimi ynë i parë ishte: Arsyetimi i juaj nr.1 Aktiviteti i prokurimit është inicuar 18.06.2024 prokurimit të vitit 2024 – Ky arsyetim nuk qëndron pasiqë çdo AP pas hapjes së ofertave pa mvarësisht se sa zgjatë edhe nëse kalon në vitin tjeter nuk mund te anulohet përveq në arsyet e cekura ne RRUOPP, Neni 44.5.
Për këtë pretendim AK me rastin e rishqyrtimit të cilin e ka quajtur si të pa bazuar duke u arsyetuar se në bazë të ankesave të njëpasnjëshme të OE ka kaluar koha e për implementim të projektit gjë që kjo nuk është e vërtetë fare pasiqë shërbimet DDD janë shërbime për të cilat mund te realizohen gjatë tërë vitit, përveq dezinsektimit hapsinor që realizohet vetem gjatë sezonës pranverë- verë. (në momentin e anulimit ne veq kemi hyrë ne sezonën e pranverës). Po ashtu nuk ka pas ankesa të njepasnjëshme por ishte vetëm ankesa e jonë për të cilën vetë AK nuk e ka shqyrtuar me kohë, apo e ka vertetuar se ne kemi pas plotesisht të drejtë dhe nuk ka mund të ndryshojë faktet për ankesën tonë që OE i shpërblyer me kontratë ishte i pa përgjegjshëm dhe kështu kanë zgjedhur të zgjasin procesin dhe në fund ta anulojnë. AK duke u munduar të arsyetohet ka thënë se arsyeja nuk është cekur në dosje të tenderit e as në njoftimin për kontratë se projekti kalon edhe në vitin 2025 por është caktuar Afati i liferimit që duhet të përfundoje brenda 10 ditëve pas lidhjes së kontratës të vitit 2024.
Është fakt që në DT është kërkuar që afati i liferimit është 10 ditë, por nuk është e vërtetë që është e shenuar pas lidhjes së kontrates të vitit 2024. Asnjë procedurë e prokurmit nuk dihet se sa do të zgjatë edhe pse për secilin proces të aktivitetit të prokurmit ekzistojnë afatet ligjore.
Pretendimi i ynë i dytë ishte: Arsyetim i juaj nr.2. Përshkak se ka kaluar edhe vlefshmëria e ofertave- Edhe ky arsyetim nuk qendron sepse për mosrespektim te Ligjit nga ana e juaj ku në këtë rast ju nuk keni respektuar LPP-në
Neni 30 Validiteti i Tenderit, 30.4 Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)

Sikur zyrtari i Prokurimit të kishte kryer punën e tij sipas udhezimeve të prokurimit publik edhe ne do të kishim vazhduar validitetin e tenderit, por AK nuk ka kërkuar vazhdimin e validitetit pasiqë ofertuesi i përgjegjshem në këtë AP nuk është OE i tyre i favorizuar por ishim ne të cilët ia deshmuam se OE që kishin shpërblyer me kontratë është i papërgjegjshëm. Kjo eshte aryseja pse është anuluar ky AP e jo arsyet e kota të cekura nga ana e AK-së.

Me arsyetimet e Anulimit te ketij AP Autoriteti kontraktues nuk ka marrë parasysh që ka bërë shkelje të rëndë sipas RREGULLORES Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK , Neni 97 Shkeljet e rënda ,
e. Mos respektimi i rregullave për trajtimin e kërkesave për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.
f. Mos zbatimi i nenit 30.4 të Rregullores së Prokurimit Publik nga zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe si rrjedhojë skadimi të afateve kohore të vlefshmërisë dhe sigurisë së tenderëve

Sipas interpretimeve te KRPP-se Mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje, andaj KRPP do të ndërmarr masa në përputhje me nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Pretendimi i ynë i tretë ishte: Arsyetimi i juaj nr.3. Sigurimi i ofertës – Ky arsyetim nuk qendron pasiqë sipas dosjes së tenderit nuk është kërkuar sigurim i ofertës fare.

Për këtë pretendim edhe AK ka pranuar gabimin e tyre për të cilin ka kërkuar ndjesë pasiqë nuk ishe kërkuar sigurimi në DT.

Pretendimi i ynë i katërt ishte:Arsyetimi i juaj nr. 4. Kërkesa e njesisë kërkuese për Anulim të procedurës nga shkaku se ka kaluar koha nga të cilët është paraparë të bëhet Dezinfektimi,dezinsektimi dhe Deratizimi i objekteve – edhe ky arsyetim është i papranueshem pasiqë shërbimet e DDD nëse janë paraparë të realizohen vitin e kaluar dhe nuk kanë mundur të realizohen , nuk janë shërbime që nuk kanë efekt të realizohen tani, sepse të njëjtin qëllim e kanë si në vitin 2024 ashtu edhe në vitin 2025. Kjo kërkesë e njësisë kërkuese me këtë arsyetim është një tregues i mirë që njësia kërkuese nuk ka mundur të realizojë shërbimin me operatorin ekonomik të favorizuar, dhe për këte arsye ka bërë këtë kërkesë për anulim.
Edhe për këtë pretendim AK me rastin e kërkesës për rishqyrtm sërish ka dhënë arsyetime të pa qëndrueshme duke thënë se arsyeja nuk është cekur në dosje të tenderit e as në njoftimin për kontratë se projekti kalon edhe në vitin 2025 por është caktuar Afati i liferimit që duhet të përfundojë mbrenda 10 ditëve pas lidhjes së kontratës të vitit 2024.
Është fakt që në DT është kërkuar që afati i liferimit është 10 ditë, por nuk është e vertetë që është e shenuar pas lidhjes së kontratës të vitit 2024. Në asnjë AP nuk caktohet se kur do të nënshkruhet kontrata pasiqë nuk dihet.

Me arsyetimet e cekura më lartë dhe me Vendimin e datës 10.04.2025 AK KUVENDI I KOMUNES – KAÇANIK edhe njëher i ka vërtetuar shkeljet si dhe ka dëshmuar haptas që neve si OE të përgjegjshëm na ka eliminuar padrejtësisht, dhe duke mos patur mundësi ta realizon këtë AP me OE të tyre të favorizuar edhe pse ishte i papërgjegjshëm ka vendosur të Anuloje këtë AP edhe pse me Anulim ka berë edhe një shkelje te LPP-së.

Sipas Nenit 62 te LPP-së Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:
-Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo
-Para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Në rastin konkret:

- Asnjë nga këto kushte nuk është përmbushur;
- Anulimi është bërë pas hapjes së ofertave, pra në kundërshtim me nenin 62;
- AK kishte kaluar përmes gjithë procedurës së nevojshme sipas nenit 9 të LPP-së dhe nenit 8.1 të RRUOPP-së, ku kërkohet që të bëhet vlerësim formal i nevojës dhe i disponueshmërisë së fondeve para inicimit të aktivitetit të prokurimit.

Pra, AK nuk do ta kishte inicuar këtë prokurim nëse nuk do ta kishte të qartë që ekzistonte nevoja dhe fondi për realizimin e shërbimit.

Por, sidoqoftë AK me eliminimin tonë në vlerësimin e ofertave në fillim, me Anulimin e ketij AP si dhe pastaj edhe me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk don ta pranojë që duhet te vazhdoje me kete aktivitet te prokurimit pasiqe vetem ne jemi OE te pergjegjshem në këtë AP. Fatmirësisht që Vendimet e padrejta të AK nuk mbeten finale por shqyrtohen edhe nga OSHP dhe ne besojmë e shpresojmë që pas shqyrtimit do të beni një vlerësim të drejtë dhe profesional.

Besojmë se ju si OSHP do te analizoni mirë kete aktivitet te prokurimit dhe te mos e lejoni qe AK duke bere shkelje te njepasnjeshme dhe duke mos kryer punen e tyre si duhet te pesojme ne si OE padrejtesisht. Pra, për të gjitha shkeleje e bëra nga AK në drejtimin tonë, ne si OE ankues shpresojmë që do të ketë drejtësi nga ju si OSHP dhe të shqyrtoni ankesën konform provave dhe argumenteve.

Nga të cekurat më lartë të cilat janë evidente kërkojmë nga OSHP të merr :

V E N D I M

1.Aprovohet si e bazuar *ankesa e* **"Besim A.Zejnullahu B.I "** lidhur me tenderin "Shërbimet e Dezinfektimit;Dezinsektimit dhe Deratizimit" me nr.të prokurimit 652-24-6096-2-2-1

2. Anulohet njoftimi për Vendimin per Anulim te tenderit lidhur me tenderin Shërbimet e Dezinfektimit;Dezinsektimit dhe Deratizimit" **me nr.të prokurimit 652-24-6096-2-2-1** ***dhe lenda te kthehet ne rivlersim.***

Shpresojmë që ju si Panel shqyrtues do të merrni një vendim të drejtë dhe të mos lejoni që një AK Komuna e kacanikut të vepron në kundërshtim me dispozitat e LPP-së (Neni1, Neni 59, dhe Neni 62) te cilat jane vene per te gjithe OE-te dhe Autoritet kontraktuese duke mos bërë asnjë përjashtim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet e konstatuara deri me tani kapin shume rreth 1,500 €

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*